

The WALT DISNEY Company

Kodi i Sjelljes për Prodhuesit

Në Kompani Walt Disney, ne synojmë :

- një standard të shkëlqyer në të gjitha aspektet e veprimtarisë sonë dhe në çdo vend të botës;
- sjellje etike dhe të përgjegjeshme në gjithë veprimtarinë tonë;
- respektimin e të drejtave të të gjithë individëve; dhe
- respektimin e mjedisit.

Të gjithë prodhuesit e mallrave Disney duhet të kenë po këto synime. Në *minimum*, ne kerkojmë që të gjithë prodhuesit e mallrave Disney të plotësojnë këto standarde :

Puna e Fëmijëve

Prodhuesit nuk përdorin punën e fëmijëve.

Termi “fëmijë” u referohet personave më të rinj se 15 vjeç (ose 14 kur ligji lokal e lejon) ose, nëse më të rritur, nën moshën minimale për punë sipas ligjit lokal ose nën moshën për të përfunduar arsimin e detyrueshëm.

Prodhuesit që punësojnë persona të rinj që nuk hyjnë në përcaktimin “fëmijë” do të veprojnë në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregullat që zbatohen për këta persona.

Puna e Detyruar

Prodhuesit nuk përdorin punë të detyrueshme ose jovullnetare, qoftë të të burgosurve, të dënuarve apo të çdo lloji tjetër.

Detyrimi dhe Ngacmimi

Prodhuesit i trajtojnë të punësuarit me dinjitet dhe respekt, dhe nuk përdorin dënime fizike, kanosje për dhunë apo forma të tjera të ngacmimit apo abuzimit fizik, seksual, psikologjik apo verbal.

Mosdiskriminimi

Prodhuesit nuk diskriminojnë në praktikën e punësimit, duke përfshirë pagën, përfitimet e tjera, ngritjen në përgjegjësi, disiplinën, largimin nga puna apo daljen në pension, mbi bazën e racës, besimit fetar, moshës, kombësisë, origjinës shoqërore apo etnike, orientimit seksual, gjinisë, bindjeve politike apo paaftësisë për punë.

Tubimi

Prodhuesit respektojnë të drejtën e punonjësve për t’u mbledhur, për t’u organizuar dhe për të zhvilluar bisedime kolektive në mënyrë të ligjshme dhe paqësore, pa dënime apo ndërhyrje.

Shëndeti dhe Siguria

Prodhuesit u vënë të punësuarve në dispozicion vende pune të sigurt dhe të shëndetshme në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregullat në fuqi, duke siguruar një minimum të arsyeshëm përdorimi të ujit të pijshëm dhe ambienteve sanitare; sigurimin nga zjarri si dhe ndriçimin dhe ajrosjen e përshtatshme. Prodhuesit garantojnë që të zbatohen të njëjtat standarde të shëndetit dhe sigurisë edhe në banesat që ata sigurojnë për punonjësit.

Pagat

Prodhuesit duhet të kuptojnë se pagat janë themelore për të siguruar nevojat bazë të punonjësve. Prodhuesit duhet, në minimum, të zbatojnë të gjitha ligjet dhe rregullat në fuqi për pagat dhe orët e punës, duke përfshirë ato që lidhen me pagën minimale, mbiorët, orët maksimale të punës, pagesat për copë dhe elemente të tjera të pagave, dhe të sigurojnë përfitimet e kërkuara nga ligji. Përveçse në rrethana të jashtëzakonshme pune, prodhuesi nuk duhet t'u kerkojë punonjësve të punojnë më shumë se kohëzgjatjen më të shkurtër nga (a) 48 orë në javë dhe 12 mbiorë pune ose (b) kufijtë e lejuar nga ligji lokal për orët e rregullta dhe mbiorët e punës, ose kur ligji lokal nuk i kufizon orët e punës, javën e rregullt të punës plus 12 mbiorë. Përveç kësaj, kur nuk ka rrethana të jashtëzakonshme pune, punonjësit kanë të drejtën e një dite pushimi në çdo periudhë shtatëditore.

Prodhuesit i shpërblejnë punonjësit për mbiorët me pagën e shtuar që kërkohet nga ligji ose, në rast se nuk ka pagë të shtuar të përcaktuar nga ligji, me një pagë së paku njëlloj me pagën e rregullt për orë.

Kur standardet e industrisë lokale janë më të larta se kërkesat ligjore, prodhuesit tanë duhet të zbatojnë standardet më të larta.

Mbrojtja e Mjedisit

Prodhuesit veprojnë në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregullat lokale të zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit.

Ligjet e Tjera

Prodhuesit veprojnë në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregullat lokale të zbatueshme, duke përfshirë ato që lidhen me prodhimin, çmimin, shitjen dhe shpërndarjen e mallit. Të gjitha referimet për "ligjet dhe rregullat e zbatueshme" në këtë Kod të Sjelljes përfshijnë kodet lokale dhe ndërkombëtare, rregullat dhe rregulloret, si dhe kontratat e zbatueshme dhe standardet industriale të pranuar vullnetarisht.

Nënkontraktimi

Prodhuesit nuk përdorin nënkontraktues për prodhimin e mallrave Disney ose një pjesë të tyre pa miratimin e posaçëm me shkrim të Disney-t, dhe vetem pasi nënkontraktuesi të bjerë dakord me shkrim me Disney-n, se do ta respektojë këtë Kodi të Sjelljes.

Kontrolli dhe Përshtatja

Prodhuesit autorizojnë Disney-n dhe agjentët e caktuar prej tij (duke përfshirë palët e treta) të kryejnë veprimtari vëzhguese për të konfirmuar respektimin e këtij Kodi të Sjelljes, duke përfshirë inspektimet e palajmëruara në ambientet e prodhimit dhe në banesat e siguruar nga punëdhënësi; inspektimin e llogarive dhe dokumentave që lidhen me problemet e punësimit; dhe intervista private me punonjësit. Prodhuesit do të mbajnë në vendin e punës gjithë dokumentacionin që mund të jetë i nevojshëm për të provuar respektimin e këtij Kodi të Sjelljes.

Publikimi

Prodhuesit do të marrin masat e përshtatsme që të garantojnë njohjen e punonjësve me dispozitat e këtij Kodi të Sjelljes, duke përfshirë edhe afishimin e një kopjeje të këtij Kodi të Sjelljes në gjuhën lokale dhe në një vend të dukshëm për punonjësit, në çdo kohë.

* * * * *